



Pranuar / Dorezuar Priljeq/Prodato Received/Delivered	27-03-2023	3	viti god year
Organ dhe/ista Org./Jedinstvo Org./Unit	Nr. Prot br. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHOL	3031/2023		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.357/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, si dhe me Kaltrina Avdullahi Prenaj - Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër, A.nr.357/2023 të datës 14.02.2023, të parashtruar nga ankuesja [redacted] ne adresë banimi: Rr "Idriz Gjilani" Hyrja III, kati 5, nr.55, në Komunën e Prishtinës, kundër Vendimit me numër protokoll Nr.736 të datës 07.12.2022 i Agjencisë së Punësimit të Kosovës, në çështjen juridike „kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 27.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.357/2023 e datës 14.02.2023 e parashtruar nga ankuesja [redacted]
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokoll Nr.736 i datës 07.12.2022 i Agjencisë së Punësimit të Kosovës.

A r s y e t i m

Udhëheqësja e Divizionit për Burime Njerëzore në Agjencinë e Punësimit, me datë 07.12.2022 ka nxjerrë Vendim me numër protokoll Nr.736 lidhur me përfundimin e marrëdhënies së punës për nëpunësen civile [redacted] për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, duke i njohur kompensimin për shkak të pensionimit në lartësinë e një (1) page mujore në vlerën e pagës së fundit.

Ankuesja [redacted] e pa kënaqur me Vendimin me numër protokoll Nr.736 të datës 07.12.2022 të lëshuar nga Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Punësimit, me datë 14.02.2023 ka parashtruar ankesë nën shenjë A.nr.357/2023, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, me pretendimin që Vendimi me numër protokoll Nr.736 i datës 07.12.2022 i Agjencisë së Punësimit të Kosovës, lidhur me rastin e përfundimit të marrëdhënies së punës me

rastin e pensionimit, përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës administrative, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe aplikim i gabuar i dispozitave ligjore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/20218 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesës, me datën 20.02.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Agjencinë e Punësimit të Kosovës. Ndërsa Këshilli, me datën 20.03.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë nga ky institucion së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 1735/2023 të datës 14.02.2023 e parashtruar nga ankuesja; Vendimin me numër Nr.736 të datës 07.12.2022 të Agjencisë së Punësimit të Kosovës; E-mail Zyrtar i datës 08.12.2022; Akt Emërimit e ankueses me numër protokolli Nr.14 të datës 28.12.2017; Formulari i të dhënave për listën e pagave i datës 10.01.2023; Kërkesa për pagesë retroaktive e datës 10.01.2023; Listë për pagë e datës 28.01.2023; Listë për pagë përcjellëse e datës 28.01.2023; Listë për pagë e datës 30.12.2023; E-mail Zyrtar i përgjegjës në ankesë e datës 20.03.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesja dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankueses, është e pabazuar, sepse:

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përveç pretendimeve që Vendimi me numër protokolli Nr.736 i datës 07.12.2022 i Agjencisë së Punësimit të Kosovës, përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës administrative, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe aplikim i gabuar i dispozitave ligjore, e njëjta pretendon se është dëmtuar materialisht sepse me rastin e pensionimit me Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës parashihet që punëtorëve ju takon pagesa në lartësi prej tri pagave jubilarë dhe tri pagave përcjellëse

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar që Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015 sipas nenit 82 të saj, ndërsa ka pasur një kohëzgjatje prej tri vitesh siç parashihet me dispozitat e nenit 90 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, përcaktohet që: „*Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet*“, mirëpo neni 81 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, respektivisht paragrafi 1 ka përcaktuar që: „*Nga MPKK, Palët mund të tërhiqen tre (3) muaj para skadimit të vlefshmërisë së saj, përmes letrës rekomanduese. Tërheqja nga kjo MPKK, shpallet në Gazetën Zyrtare të Kosovës*“, bazuar në këtë Oda Ekonomike e Kosovës si nënshkruese e kësaj marrëveshje më datë 15.09.2017 ka njoftuar Ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për tërheqjen nga zbatimi i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive për arsye ligjore. Po ashtu duke u bazuar në nenin 82 paragrafi 2 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive e Kosovës ku përcaktohet se: „*Nëse nga MPKK, pasi që i skadon afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra nga Palët, zbatimi i saj vazhdon edhe për një vit*“, nga rrjedh se zbatimi i kësaj marrëveshje do të vazhdonte edhe një vit pas skadimit të afatit të përcaktuar, mirëpo meqenëse njëri nga nënshkruesit e kësaj marrëveshje është tërhequr nga zbatimi i saj, tre muaj para skadimit e njëjta nuk vlen nga data e tërheqjes.

Meqenëse konstatohet se nga data 15.09.2017, Kontrata e Përgjithshme Kolektive e Kosovës nuk është e zbatueshëm, pra nuk mund të prodhojë asnjë pasojë juridike sepse më nuk është nënshkruar nga institucionet kompetente. Andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi që ka



konstatuar se marrëdhënia e punës së ankueses me rastin e pensionimit i ka përfunduar sipas Vendimit me numër protokolli Nr.736 i datës 07.12.2022 i nga Zëvendës Udhëheqësit të Divizionit për Burime Njerëzore në Agjencisë e Punësimit të Kosovës, atëherë kompensimi i tri pagave me rastin e pensionimit sipas Marrëveshja Kolektive të Kosovës nuk mund të bëhet.

Agjencia e Punësimit e Kosovës, në bazë të listës së pagave të muajit janar 2023 ankueses i ka bërë kompensimin e një page mujore të njëhershme në vlerën e pagesë së fundit, sipas dispozitave të nenit 22 paragrafit 2 nën paragrafit 2.2 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe dispozitat e nenit 19 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë i cili përcakton që: „**Paragrafi 1. Sipas nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit në Shërbimin Civil, gëzon të drejtën e kompensimit**”. **Paragrafi 2. Nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit, gëzon të drejtën e marrjes së një pagese në shumën e një (1) page mujore të njëhershme në vlerën e pagesë së fundit**”, rrjedhimisht Agjencia e Punësimit të Kosovës ka vepruar në pajtim me legjislacionin në fuqi, sepse ky vendim përmban konstatim të saktë të gjendjes faktike dhe juridike, kështu që të gjitha pretendimet ankimore të ankueses kundër këtij vendimi si dhe pretendimet ankimore për kompensimin e dy pagave përcjellëse me rastin e pensionimit dhe tri pagave jubilarë sipas Marrëveshja Kolektive e Kosovës janë të pabazuara.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga institucioni, duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitivin të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër: A.nr.357/2023

Kaltrina Avdullahi-Prenaj



Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI



Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses, _____;
- Udhëheqësit të Divizionit për Burime Njerëzore të Agjencisë së Punësimit të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

